



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

V E N D I M

Nr. 6 Datë 10.04.2017

PËR MIRATIMIN E KËRKESËS

“ PËR PËRDORIM TË BURIMEVE UJORE ”

Në mbështetje të ligjit nr.111/2012 dt.15.12.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të nenit 38 “Qëllimet e përdorimit të burimeve ujore” gërma b, dhe të nenit 41 “Përdorimi me leje i ujit” gërma a dhe ë; të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 , “ Për miratimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje për përdorim të burimeve ujore”, bazuar në relacionin e paraqitur nga A.B.U. Drin-Bunë, miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponencës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë,

V E N D O S I :

1- Të miratojë kërkesën e subjektit “ **KILIC AQUACULTURE ALBANIA SH.A**” me administrator **z. Taner SEKER** , me përfaqësues të posaçëm **z.Ozan KARATAS dhe Saimir TODI** , me vendodhje në qytetin Vau-Dejes, Njësia Administrative Vau Dejes, **Bashkia Vau Dejes , Qarku Shkodër** për përdorim të burimeve ujore nga pompat e ish fabrikes se Pasurimit të Bakrit në **Vau Dejes , degë të lumit Drin , për Akuakulturë.**

Vepra e marrjes ka këto koordinata:  $X_1 - 43\ 87\ 751.4$ ;  $Y_1 - 46\ 53\ 567.8$ ;  $Z_1 - + 44\ m$ ;  
Pika e shkarkimit ka këto kordinata :  $X_1 - 43\ 87\ 625.5$ ;  $Y_1 - 46\ 53\ 611.8$ ;  $Z_1 - + 37\ m$ ;  
Prurja mesatare vjetore e burimit është  $0.65\ m^3/sec$ .  
Prurja mesatare e muajit më të thatë është  $0.5\ m^3/sec$ .  
Sasia e ujit që kërkohet të përdoret nga subjekti është  $0.02\ m^3/sec$  , (20 l/sek).

2-Leja e përdorimit të burimit ujor jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zone dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin- Bunë për ndjekjen e procedurave përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

SEKRETAR  
Martin PLLUMBI



KRYETAR  
Paulin RADOVANI